- Fondi i planifikuar për riparim paisje makinash do të jetë në vlerën **450 mijë lekë** në të njëjtin nivel me vitin 2013. Gjatë këtij viti do të shlyhet edhe vlera prej 186 mijë lekësh detyrim nga viti 2013.
- Fondi i planifikuar për materiale elektrike dhe hidraulike për vitin 2014 do të jetë 50 mijë lekë më pak se plani i vitit 2013, pra në vlerën **250 mijë lekë**. Gjatë vitit 2014 do të shlyhet edhe vlera prej 159 mijë lekësh detyrim nga viti 2013.
- Fondi i planifikuar për ruajtjen e Bashkisë për vitin 2014 do të jetë **3,100 mijë lekë** dhe krahasuar me planin e vitit 2013 ka një ulje prej 475 mijë lekë ose 14% më pak se plani i vitit 2013. Vlera prej 638 mijë lekësh përbën detyrim nga viti 2013 dhe do të shlyhet gjatë vitit 2014.
- Për vitin 2014 fondi i planifikuar për Shkollën e Maltës do të jetë në të njëjtën vlerë me vitin 2012 dhe 2013 pra në vlerën **600 mijë lekë**. Ky fond do të përdoret për përballimin e një pjese të shpenzimeve të nevojshme për energjinë elektrike, ujin, karburant për ngrohje dhe konkretisht 200 mijë lekë për karburantin dhe 400 mijë do të përdoret për pagesën e faturave të konsumit të ujt, energjisë elektrike dhe shpenzimeve telefonike.
- Edhe për vitin 2014 kontributi për qendrën e Kujdesit Paliativ "Mary Potter" do të jetë **500 mijë lekë**, e njëjtë me vitin 2012 dhe 2013. Ky fond do të përdoret për mbulimin e disa shpenzimeve operative si: shpenzime për karburant për ngrohje në vlerën 400 mijë lekësh, 40 mijë lekë për shpenzime kancelarie dhe 60 mijë për pagesë e faturave të konsumit të energjisë elektrike.
- Për vitin 2014 fondi i planifikuar në zërin "Prodhim i revistës, broshura abonime" do të jetë në vlerën **2,000 mijë lekë**, 680 mijë lekë më pak se viti 2013 ose 34% më pak. Në këtë zë është përfshirë botimi i revistës të Bashkisë "Qyteti im", botime të broshurave të ndryshme, abonime në gazeta dhe revista të ndryshme, prodhime dhe transmetime spotesh tv. 614 mijë lekë do të jetë detyrim nga viti 2013 dhe do të shlyhet gjatë vitit 2014.
- Fondi i planifikuar për zërin shpenzime pritje për vitin 2014 do të jetë **100 mijë lekë** të cilat do të përdoren për pritjen dhe përcjelljen e delegacioneve të huaja duke u bazuar në VKM nr. 228 datë 23.04.2004 "Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore dhe VKM nr. 258 datë 03.06.1999 "Për një ndryshim në VKM nr 243 datë 15.05.1995 "Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja". Ky fond i krahasuar me vitin 2013 ka një ulje prej 50 mijë lekësh.
- Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore fondi i planifikuar për këtë vit do të jetë në vlerën **10,000 mijë lekësh**.

- Fondi i planifikuar për regjistrimin e pronave të Bashkisë në Zyrën e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme për vitin 2014 do të jetë **350 mijë lekë**. Kjo llogaritje është kryer sipas VKM nr 1532 datë 19.11.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Korçë, të Qarkut Korçë.
- Fondi i planifikuar për vijëzimin e rrugeve të qytetit do të jetë 2,733 mijë lekë dhe kryesisht për vijëzime për këmbësorë (vendkalime) dhe vijëzime për ndarje korsie + parkimi. Ky fond nuk ka qenë planifikuar gjatë vitit 2013.
- Fondi i planifikuar për pagesën e komisionit për tatimin e thjeshtuar të Biznesit të Vogël në vlerën 1,000 mijë lekë. Ky fond u planifikua në zbatim të ligjit nr. 181/2013 datë 28.12.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksavbe vendore" të ndryshuar si dhe udhëzimi i MF nr. 32 datë 31.12.2013 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", pika b) , Administrata tatimore qendrore për shërbimin që kryen , merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësisve vendore, i cili është në masën 1% dhe derdhet në llogari të administratës tatimore qendrore. Komisioni kalon në llogari të buxhetit , në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përdorimin e të ardhurave dytësore, të krijuara në institucionet buxhetore, për mbulimin e kostove të "pullave të tatimit".

Në buxhetin e Bashkisë janë planifikuar dhe mjaft zëra të tjerë të cilat janë të detajuara në tabelën e shpenzimeve operative.

#### PROJEKTET 2014

Projektet për vitin 2014, të cilat do të menaxhohen nga Bashkia dhe Institucionet e varësisë janë në vlerën **6,827 mijë lekë**. Këto projekte janë përfshirë në shpenzimet operative dhe transfertat për Bashkinë dhe Institucionet e varësisë paraqiten të detajuara si më poshtë:

Bashkia	3,694 mijë lekë
Qendra e Artit dhe kultures	1,600 mijë lekë
NSHMAC	1,533 mijë lekë

Fondi i planifikuar për realizimin e projekteve për Bashkinë gjatë vitit 2014 është në vlerën **3,694 mijë lekë** ku **1,894 mijë lekë** janë shpenzime operative dhe **1,800 mijë lekë** përfshihen në transfertat dhe jepet i detajuar si më poshtë:

Emertimi i Projektit						
	Sherbime te print & publikimit	Shp qeramarrje aparate paisje	Shp pritje percjellje	Shp te tjera	Transferim fondi per ofrimin e sherbimit	
	6022010	6026300	6029001	6029099	6044099	TOTALI
Karta per pensionistët	250,000					250,000
Festa e Birres		1,000,000				1,000,000
Panairi I punes	30,000					30,000
Punesimi sezonal	5,000		25,000			30,000
Konference per PPP	200,000					200,000
Festivali I ushqimit		100,000				100,000
Korca City map				20,000		20,000
Qender komunitare per moshen e trete					1,000,000	1,000,000
Kalendari I aktiviteteteve 2014	100,000					100,000
Panairi I pranveres		40,000				40,000
Dita nderkombetare e PAK	20,000			40,000		60,000
Mbeshtetje per personat e moshuar dhe					400,000	400,000

vetmuar						
Dita e jetimeve	20,000			44,000		64,000
Qendra komunitare per femijet ne nevoje					400,000	400,000
<b>TOTALI</b>	<b>625,000</b>	<b>1,140,000</b>	<b>25,000</b>	<b>104,000</b>	<b>1,800,000</b>	<b>3,694,000</b>

✓ **Projekti "Karta për pensionistët"**

<b>Nr.</b>		
1	<b>Programi</b>	Qyteti Social
2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Karta për pensionistët</b>
3	<b>Kohëzgjatja</b>	N vazhdim si
4	<b>Data e fillimit</b>	Janar 2014
5	<b>Donatorë potencialë</b>	N/A
6	<b>Kostoja totale</b>	250 000
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	250 000
8	<b>Fond shtesë</b>	N/A
9	<b>Rezultatet</b>	Cdo pensionist përfiton: - falas shërbimin e transportit urban, - ndjekjen e ndeshjeve në stadium dhe në pallatin e sportit, ulje të cmimit të biletës në teatër në masën 50% si dhe ulje në masën 20%- - 50% në disa shërbime si në njësi tregtimi, apo shërbimesh të nevojshme për moshën e tretë. --- disa shërbime e analiza mjekësore falas nga klinika në qytetin tonë.
10	<b>Objektivat</b>	Ky projekt ka për qëllim krijimin e një sistemi shërbimesh falas apo me cmime të reduktuara në fusha me interes për të gjithë pensionistët e qytetit të Korçës.
11	<b>Aktivitetet kryesore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Regjistrimi i pensionistëve në sportelet e Zyrës së informimit qytetar</li> <li>- Printimi dhe shpërndarja e kartave sipas listës</li> <li>- Monitorimi i realizimit të shërbimeve të ofruara për pensionistët nga ofruesit e reduktuar</li> </ul>
12	<b>Organizata implementuese</b>	Zyra e Informimit Qytetar, Bashkia Korçë
13	<b>Zyra Përgjegjëse</b>	Zyra e Politikave të Zhvillimit dhe Projekteve Strategjike .
14	<b>Shënime</b>	

✓ **Festa e Birrës 2014**

<b>Nr.</b>		
1	<b>Program</b>	Shpirti i traditës
2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Festa e Birrës 2014</b>
3	<b>Kohëzgjatja</b>	13-17 gusht
4	<b>Data e fillimit</b>	Qershor 2014
5	<b>Donatorët potencialë</b>	Bashkia Korçë Kompani telefonike Banka Fondacione të huaja Bisnese që janë të interesuara etj
6	<b>Kostoja totale</b>	8.000.000 Lek
7	<b>Fondi i Bashkisë</b>	1.000.000 Lek
8	<b>Fond shtesë</b>	7.000.000 Lek

9	<b>Rezultatet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Festa e birrës si një nga festat kryesore të qytetit do të krijojë një atmosferë festive në qytetin e Korçës duke gjallëruar nëtët verore, duke tërhequr turistë brenda dhe jashtë vendit, duke e kthyer këtë festë në traditë si një festë që festohet vetëm në Korçë.</li> <li>- Impakt direkt dhe indirekt në rritjen të ardhurave të bizneseve të rajonit</li> </ul>
10	<b>Objektivat</b>	Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit si dhe forcimi i traditave të Korçës dhe rrethinave .
11	<b>Aktivitetet kryesore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi i planit të punës dhe marketingut</li> <li>- Gjetja e fondeve</li> <li>- Kontakte me donator të mundshëm dhe pjesëmarrës potenciale</li> <li>- Menaxhimi i eventit</li> <li>- Promovimi i eventit</li> <li>- Realizimi i shoë-t</li> <li>- Realizimi i Kendit të femijeve</li> <li>- Përgatitje e infrastruktures së nevojshme</li> <li>- Realizimi i festës së birrës</li> </ul>
12	<b>Institucioni zbatues</b>	Bashkia Korçë
13	<b>Zyra Përgjegjëse</b>	Zyra e Politikave të zhvillimit dhe projekteve strategjike

✓ **Panairi i punës dhe Punësimi Sezonal**

<b>Nr.</b>		
1	<b>Program</b>	Qyteti mbështet të rinjtë
2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Panairi i punës dhe punësimi sezonal</b>
3	<b>Kohezgjatja</b>	5 muaj (maj-shtator)
4	<b>Data e fillimit</b>	Maj
5	<b>Donatorët potenciale</b>	GIZ ARZH Tabita Dorcas Banka Kompani telefonike Fondacione të tjera
6	<b>Kostoja totale</b>	250.000Lek
7	<b>Fondi i Bashkise</b>	60.000Lek
8	<b>Fond shtese</b>	190.000Lek
9	<b>Rezultatet</b>	
10	<b>Objektivat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkëpunim me një sërë aktorësh , ndërveprimi i të cilëve do të risë efikasitetin dhe do të ndihmojë në arritjen e rezultateve konkrete për punëkërkesit dhe punëmarrësit.</li> <li>- Ofrimi i mundësive për studentët e fakulteteve të ndryshme, për të vënë në praktikë dijet e fituara gjatë kurrikulave mësimore.</li> <li>- Përfshirja e studentëve në strukturat administrative, si një</li> </ul>

		shans më shumë për të rritur eksperiencat e tyre në punë.
11	<b>Aktivitetet kryesore</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1- Ngritja e grupit të punës</li> <li>2- Hartimi i planit të punës</li> <li>3- Gjetja e donatoreve</li> <li>4- Vendosja e kontakteve me bizneset dhe institucionet që operojnë në rajon.</li> <li>5- Identifikim i kërkesave aktuale për punësim</li> <li>6- Trajnim me përfaqësuesit e bizneseve</li> <li>7- Vendosja e kontakteve me studentet dhe punëkërkuarit</li> <li>8- Trajnim me punëkërkuarit</li> <li>9- Fushatë promovionale që do të publikojë dhe lehtësojë procedurën dhe kontaktet në këtë proces.</li> <li>10- Organizimi i Panairit të Punës</li> </ol> <p><u>Punësimi sezonal</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>11- Përgatitja e formularëve të aplikimit për studentët potencialë.</li> <li>12- Fushata marketing dhe promovimi në media.</li> <li>13- Shpërndarja e flete aplikimeve në universitetin publik "Fan. S. Noli".</li> <li>14- Intervistimin e aplikantëve dhe ndarja e tyre në drejtoritë dhe projektet e Bashkisë.</li> <li>15- Lançimi i projektit</li> <li>16- Monitorimi i projektit.</li> <li>17- Finalizimi i projektit dhe shpërndarja e çertifikatave për pjesëmarrësit.</li> </ol>
12	<b>Institucioni zbatues</b>	Bashkia Korçë
13	<b>Zyra Përgjegjëse</b>	Zyra e Politikave të zhvillimit dhe projekteve strategjike

✓ **Konferencë Ndërkombëtare për PPP**

<b>Nr.</b>		
1	<b>Programi</b>	Shpirti i Traditës
2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Konferencë Ndërkombëtare për PPP</b>
3	<b>Kohëzgjatja</b>	Gjatë vitit 2014
4	<b>Data e fillimit</b>	Shkurt 2014
5	<b>Donatorë potencialë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkia Korçë</li> <li>- Investitorë të interesuar</li> </ul>
6	<b>Kostoja totale</b>	1000 000 Lek
7	<b>Fondi i Bashkisë</b>	200 000 Lek
8	<b>Fond shtesë</b>	800 000 Lek
9	<b>Rezultatet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxitja e investimeve në qytet dhe rritja e mundësisë për të investuar në Korçë.</li> <li>- Prezantimi i ideve të bashkisë Korçë për zhvillimin e partneritetit publiko-privat .</li> <li>- Tërheqja e investitorëve vendas dhe të huaj</li> </ul>
10	<b>Objektivat</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1- Zhvillimin e mëtejshëm të partneritetit publiko-privat, me synim përmirësimin e jetesës së qytetarëve si dhe nxitjen e investimeve në qytet.</li> <li>2- Gjallërimin e bizneseve vendase dhe të huaja.</li> <li>3- Prezantimin e mundësive dhe ideve për zhvillimin e PPP-</li> </ol>

		ve në qytetin e Korçës.
11	<b>Aktivitetet kryesore</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1- Evidentimi i aseteve në pronësi të qytetit,që mund të zhvillohen përmes PPP.</li> <li>2- Përgatitja e një prezantimi për secilin aset, ku përfshihen gjendja aktuale, mundësitë për zhvillim në përputhje me planin e ri urbanistik të Korçës.</li> <li>3- Përgatitja e konferencës.</li> <li>4- Zhvillimi i konferencës.</li> </ol>
12	<b>Institucioni zbatues</b>	Bashkia Korçë

✓ **Festivali i Ushqimit**

<b>Nr.</b>		
1	<b>Program</b>	<b>Shpirti i traditës</b>
2	<b>Titulli i projektit</b>	Festivali i ushqimit
3	<b>Kohëzgjatja</b>	Qershor – shtator
4	<b>Data e fillimit</b>	Maj 2014
5	<b>Donatoret potenciale</b>	Bashkia Korçë Fondacione dhe biznese të interesuar në këtë drejtim
6	<b>Kostoja totale</b>	400.000 Lek
7	<b>Fondi i Bashkise</b>	100.000 Lek
8	<b>Fond shtese</b>	300.000 Lek
9	<b>Rezultatet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rritja e shitjeve si dhe e frekuentimit të restoranteve pjesëmarrëse edhe gjatë ditëve të javës</li> <li>- Organizimi i një panairi ku do të reklamohen gatimet tradicionale të qytetit</li> <li>- Promovimi i lokaleve dhe restoranteve të qytetit</li> </ul>
10	<b>Objektivat</b>	Promovimi i vlerave tradicionale të gastronomisë, nxitja e frekuentimit të restoranteve të qytetit dhe gjallërimi i jetës në qytet edhe gjatë javës
11	<b>Aktivitetet kryesore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikimi i restoranteve pjesëmarrëse në panair dhe në festivalin e ushqimit</li> <li>- Gjetja e fondeve</li> <li>- Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për organizimin e panairit</li> <li>- Përgatitja e materialeve promociionale</li> <li>- Organizimi i panairit dhe fillimi i festivalit të ushqimit</li> <li>- Monitorimi dhe ndjekja e këtij aktiviteti gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj</li> <li>- Finalizimi i projektit dhe nxjerja e rezultateve dhe pritshmërive</li> </ul>
12	<b>Institucioni zbatues</b>	Bashkia Korçë
13	<b>Zyra Përgjegjëse</b>	Zyra e Politikave të zhvillimit dhe projekteve strategjike

✓ **Korça City Map**

<b>Nr.</b>		
1	<b>Programi</b>	Shpirti i Traditës
2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Korça City Map</b>
3	<b>Kohëzgjatja</b>	Janar- Shkurt 2014
4	<b>Data e fillimit</b>	Janar 2014

5	Donatorë potencialë	- Institucionet dhe bizneset lokale - Agjensia Rajonale e Zhvillimit (ARZH)
6	Kostoja totale	200 000 Lek
7	Fondi i bashkisë	20 000 Lek
8	Fond shtesë	180 000 Lek
9	Rezultatet	- Realizimi dhe publikimi i hartës turistike " Korça City map" - Lehtësi orientuese në qytet për vizitorët vendas dhe të huaj.
10	Objektivat	- Përmirësimi i shërbimit turistik në qytet. - Publikimi i hartës turistike të qytetit të Korçës.
11	Aktivitetet kryesore	- Konfirmimi i bizneseve pjesëmarrëse - Mbledhja e informacioneve për publikim - Dizajnimi i hartës - Printimi dhe publikim i hartës turistike
12	Institucioni zbatues	Bashkia Korçë
13	Zyra Përgjegjëse	Zyra e Politikave të Zhvillimit dhe Projekteve Strategjike .

✓ Projekti "Qendra Komunitare për moshën e tretë"

Nr.		
1	Programi	Qyteti Social
2	Titulli i projektit	<b>Qendra Komunitare për moshën e tretë</b>
3	Kohëzgjatja	N vazhdim si
4	Data e fillimit	Janar 2014
5	Donatorë potencialë	
6	Kostoja totale	2 569 000
7	Fondi i bashkisë	1 000 000
8	Fond shtesë	1 569 000
9	Rezultatet	- Vazhdueshmëria e një punë shumë të mirë dhe një experience 4 vjecare për të krijuar ambiente sa më mikëpritëse në Qendrat Komunitare. - Zvogëlimi i fenomenit të braktisjes dhe vetmisë të Moshës së Tretë. - Vazhdimësia e përmirësimit të shërbimeve sociale në qytetin e Korçës.
10	Objektivat	Krijimi i kushteve të pershtatshme dhe ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, mjekesore, kulturore e argetuese për të moshuarit me qëllim zbutjen e problemeve të moshës së tretë dhe shmangies e izolimit social të tyre. <b>Objektiva 1: Ofrimi i një mjedisi çlodhës dhe mikëpritës për të moshuarit.</b> <b>Objektiva 2: Ofrimi i shërbimeve të specializuara sociale nëpërmjet 3 kujdestarëve të qendrave, punonjësit sociale dhe atij animator.</b> <b>Objektiva 3: Organizimi i aktiviteteve social-kulturore, argëtuese</b> <b>Objektiva 4: Përmirësimi i kushteve shëndetsore të frekuentuesve të Qendrave</b> <b>Objektiva 5: Ofrimi i shërbimeve të tjera të nevojshme për të moshuarit.</b>
11	Aktivitetet kryesore	<b>Aktiviteti 1: Vazhdimi i Ofrimi të kafes dhe çajit për</b>

		<p><b>çdo të moshuar</b> që frekuenton këto qendra nga ora 8-16.</p> <p><b>Leximi i shtypit të ditës.</b> Cdo ditë do tju ofrohen pranë këtyre Qendrave shtypi i ditës, 5 gazeta për secilin Qendër. Gazetat e sjella do të zgjidhen nga vetë të moshuarit.</p> <p><b>Aktiviteti 2: Shërbime nga 3 kujdestarë të përhershëm në secilën prej qendrave.</b> Ata kanë qënë të vëmendshëm edhe për raste të vecanta kur të moshuarit kanë shfaqur shenja problemesh shëndetsore apo probleme sociale. Këta kujdestarë janë bërë njerëz shumë të dashur për të moshuarit që frekuentojnë këto qendra sepse tani është viti i 4 që ata njihen me njëri tjetrin dhe është krijuar një miqësi e vecantë midis tyre.</p> <p><b>Shërbime të specializuara nga 1 punonjës social për Qendrat komunitare.</b> Do ti kushtohet përsëri një rëndësi e vecantë anës psikologjike të të moshuarve duke iu ofruar një punonjës social që do të dëgjojë të moshuarit, do të diskutojë dhe do të jetë i hapur për problemet dhe shqetësimet e tyre.</p> <p><b>Shërbime të specializuara nga 1 punonjës animator për Qendrat komunitare.</b> Puna me animatorin social ka qënë një punë shumë e mirë dhe e pelqyer nga të moshuarit. Kështu që do të vazhdohet në këtë rrjedhë edhe vitin që vjen. Do të ketë organizimi, lojra apo tema diskutimi që iu interesojnë të moshuarve.</p> <p><b>Aktiviteti 3: Ofrimi i aktiviteteve të ndryshme sociale – kulturore</b> Gjatë vitit 2013 ekskursionet, aktivitetet dhe veprimtaritë e tjera që janë organizuar kanë qënë të vlerësuar nga të moshuarit dhe kanë kaluar gjithmonë në një atmosferë të gëzueshme. Kështu duke patur edhe më shumë përvojë edhe për Vitin 2014 do të ketë ekskursione, organizime të ndryshme si ditëlindje, festa kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe aktivitete të tjera social-kulturore.</p> <p><b>Aktiviteti 4: Ndërhyrje dhe vizita mjekësore</b> Dosjet personale për cdo të moshuar që ka frekuentuar në mënyrë të rregullt qendrat komunitare kanë qënë shumë të nevojshme për të parë vazhdimësinë shëndetsore të tyre. Zherë në javë në secilën nga Qendrat ku do të bëhet majta e tensionit, matja e nivelit të sheqerit në gjak për personat që vuajnë nga diabeti. Gjithashtu do të vazhdojnë edhe vizitat mjekësore për të moshuarit që janë të braktisur dhe nuk kanë mundësi të shkojnë vetëm.</p> <p><b>Aktiviteti 5: Ofrim shërbimesh të tjera</b> Ky shërbim konsiston në ofrimin e një vakti të ngrohtë të përditshëm dhe pastrimin në shtëpitë e të moshuarve 1 herë në javë. Ky shërbim është ofruar kundrejt një pagese minimale duke marrë parasysh vlerën e pensionit të të moshuarve, specifike në cdo rast specific. Gjatë muajve të fundit të vitit 2013 u krijua një shembull pozitiv me ofrimin e këtyre shërbimeve disa prej këtyre të moshuarve të cilët ishin shumë të kënaqur nga ofrimi i një vakti të ngrohtë dhe të pastrimit në shtëpitë e tyre. Si dhe nga kujdesi që punonjëset kanë treguar kundrejt këtyre të moshuarve.</p>
12	<b>Organizata implementuese</b>	
13	<b>Zyra Përgjegjëse</b>	Zyra e Politikave të Zhvillimit dhe Projekteve Strategjike .

14	Shënime	
----	---------	--

### ✓ Kalendar i Aktiviteteve 2014

Nr.		
1	<b>Programi</b>	Shpirti i Traditës
2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Kalendar i Aktiviteteve 2014</b>
3	<b>Kohëzgjatja</b>	Janar-Shkurt – Mars 2014
4	<b>Data e fillimit</b>	Janar 2014
5	<b>Donatorë potencialë</b>	
6	<b>Kostoja totale</b>	100 000 Lek
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	100 000 Lek
8	<b>Fond shtesë</b>	-
9	<b>Rezultatet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pasurimi i materialeve promocionale për përfaqësimin e qytetit në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare .</li> <li>- Informimi i vizitorëve vendas dhe të huaj për aktivitetet e zhvilluara në qytet.</li> </ul>
10	<b>Objektivat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Promovimi i paketës së plotë të eventeve të rajonit të Korçës.</li> <li>- Promovimi i aktiviteteve social-kulturore e turistike të qytetit dhe atraksioneve turistike.</li> </ul>
11	<b>Aktivitetet kryesore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbledhja e informacioneve për aktivitetet që do të publikohen.</li> <li>- Printim dhe publikim i kalendarit.</li> </ul>
12	<b>Organizata implementuese</b>	Bashkia Korçë
13	<b>Zyra Përgjegjëse</b>	Zyra e Politikave të Zhvillimit dhe Projekteve Strategjike .

### ✓ Panairi i Pranverës

Nr.		
1	<b>Program</b>	Shpirti i traditës
2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Panairi i pranverës</b>
3	<b>Kohëzgjatja</b>	Prill 2014
4	<b>Data e fillimit</b>	Mars 2014
5	<b>Donatoret potenciale</b>	Bashkia Korce Fondi Amerikan i Zhvillimit UNDP Kompani Telefonike Banka
6	<b>Kostoja totale</b>	1.500.000 Lek
7	<b>Fondi i Bashkise</b>	40.000 lek
8	<b>Fond shtese</b>	1.460.000lek
9	<b>Rezultatet</b>	- Gjallërimi i jetës kulturore artistike në qytet

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sjellja e sa më shumë vizitorëve në qytet</li> <li>- Rritja e të ardhuravë të bizneseve që lidhen direkt apo indirekt me turizmin (Bare, restorante, hotele etj)</li> </ul>
10	<b>Objektivat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vazhdimësia e këtij eventit krahas eventeve të shumta të qytetit, i cili synohet të kthehet në traditë të përvitshme.</li> <li>- Kthimi i aktivitetit në një atraksion turistik</li> <li>- Pasurimi i jetës social kulturore të qytetarëve të Korçës.</li> </ul>
11	<b>Aktivitetet kryesore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjetja e fondeve</li> <li>- Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme</li> <li>- Kontakte më persona dhe biznese të interesuar të marrin pjesë në panair</li> <li>- Hartimi i programit festiv</li> <li>- Dekori i qytetit</li> <li>- Përgatitja e materialeve promociionale</li> <li>- Zhvillimi i aktiviteteve</li> <li>- Monitorimi i tyre</li> <li>- Mbyllja e panairit dhe përcaktimi i rezultateve dhe pritshmëritë</li> </ul>
12	<b>Organizata implementuese</b>	Bashkia Korçë
13	<b>Zyra Përgjegjëse</b>	Zyra e Politikave të zhvillimit dhe projekteve strategjike

#### ✓ Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar

<b>Nr.</b>		
1	<b>Programi</b>	Qyteti Social
2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Dita Ndërkombëtare e Personave PAK</b>
3	<b>Kohëzgjatja</b>	3 Nëntor – 3 Dhjetor
4	<b>Data e fillimit</b>	3 Nëntor
5	<b>Donatorë potencialë</b>	
6	<b>Kostoja totale</b>	<b>60 000 Lek</b>
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	<b>60.000 Lek</b>
8	<b>Fond shtesë</b>	
9	<b>Rezultatet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Personat me aftësi të kufizuar treguan përmes këtij projekti , qe edhe at atë mund të jene pjesë active e jetës sportive të qytetit .</li> </ul>
10	<b>Objektivat</b>	1- Gjithëpërfshirja e PAK në aktivitetet sportive të zhvilluara në qytet
11	<b>Aktivitetet kryesore</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1- Kontaktet me institucionet qe merren me PAK</li> <li>2- Përgatitja e banerave dhe ftesave</li> <li>3- Blerja e uniformave sportive (bluza)</li> <li>4- Realizimi i aktivitetit në datë 3 dhjetor</li> </ol>
12	<b>Organizata implementuese</b>	Bashkia Korçë
13	<b>Zyra Përgjegjëse</b>	Zyra e Politikave të Zhvillimit dhe Projekteve Strategjike .

✓ Projekti “Mb shtetje p r personat e moshuar t vetmuar”

Nr.		
1	<b>Programi</b>	Qyteti Social
2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Mb shtetje p r personat e moshuar t vetmuar</b>
3	<b>Kohëzgjatja</b>	N vazhdim si
4	<b>Data e fillimit</b>	Janar 2014
5	<b>Donatorë potencialë</b>	
6	<b>Kostoja totale</b>	4,591,808
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	400 000
8	<b>Fond shtesë</b>	4,191,808
9	<b>Rezultatet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Dy qendrat e reja komunitare u ngritën,</li> <li>- U akomoduan 100 pleq të vetmuar, të cilët për shkak të varfërisë pensionit të ulët, vetmisë, kushteve familjare, jetojnë nën efektet e depresionit, pasigurisë dhe sëmundjeve të patrajtuara.</li> </ul>
10	<b>Objektivat</b>	<p>Qilimi: Zbutja e problemeve sociale integruese te grupmoshes se trete</p> <p>Objektivat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësimi i jetës social-psikologjike të personave të moshuar dhe të marxhualizuar/vetmuar</li> <li>- Rritja e vet vlerimit dhe dinjitetit të këtij target grupi nëpërmjet integritit social dhe aktivitetit të tyre</li> </ul>
11	<b>Aktivitetet kryesore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Evidentimi i Personave të moshuar të vetmuar.</li> <li>- Regjistrimi dhe futja e tyre në qendër.</li> <li>- Zbutja e problematikës që ndeshet në grup moshën e sipër përmendur duke u socializuar me njëri-tjetrin dhe duke përfituar falas një kafe/caj, shtypin e përditshëm,</li> <li>- aktivitete të ndryshme psiko-sociale nga e hëna në të premte për të jetuar jetën e tyre me dinjitet dhe vlerësim.</li> </ul>
12	<b>Organizata implementuese</b>	
13	<b>Zyra Përgjegjëse</b>	Zyra e Politikave të Zhvillimit dhe Projekteve Strategjike .

## ✓ Dita e Jetimeve

Nr.		
1	Programi	Qyteti Social
2	Titulli i projektit	<b>Dita e Jetimeve</b>
3	Kohëzgjatja	1-20 Maj
4	Data e fillimit	1 Maj
5	Donatorë potenciale	
6	Kostoja totale	64.000lek
7	Fondi i bashkisë	64.000lek
8	Fond shtesë	
9	Rezultatet	Lehtësimi sa me pak kushtet e veshtira te jeteses dhe platesimi i nevojave minimale te tyre.
10	Objektivat	- Te platesohen nevojat minimale te jeteses.
11	Aktivitetet kryesore	- Pergatitja e materialeve promocionale - Blerja e materialeve qe do shperndahen (pampers) - Zhvillimi i aktivitetit ne Shtepine e Foshnjes.
12	Organizata implementuese	
13	Zyra Përgjegjëse	Zyra e Politikave të Zhvillimit dhe Projekteve Strategjike .
14	Shënime	

## ✓ Projekti "Qend r komunitare p r f mij t n nevoj "

Nr.		
1	Programi	Qyteti Social
2	Titulli i projektit	<b>Qend r komunitare p r f mij t n nevoj</b>
3	Kohëzgjatja	N vazhdim si
4	Data e fillimit	Janar 2014
5	Donatorë potenciale	
6	Kostoja totale	9 799 355
7	Fondi i bashkisë	400 000
8	Fond shtesë	9 399 355
9	Rezultatet	- ngritja e një qendre komunitare për fëmijët në nevojë (përfituan 30 fëmijë në nevojë) - shërbime të specializuara, për të reduktuar braktisjen shkollore dhe nxitje afërmim e fëmijëve në mjediset shkollore. Mund të përmendim shërbimin e specializuar nga 2 mësuese të cilat lehtësuan përgatitjen e mësimeve nga fëmijët pas përfundimit të mësimit, - shërbimin nga 1 kuzhinierë duke ju ofruar një vakt të ngrohtë ushqimor në ditë, - ekskursione dhe aktivitete sociale si dhe - vizita mjekësore dhe ofrim i medikamenteve në rast nevojë.
10	Objektivat	Q llimi: Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe ofrimi i shërbimeve sociale dhe edukative, mjekësore, kulturore dhe argëtuese për fëmijet romë dhe egjiptianë në nevojë.
11	Aktivitetet kryesore	- Evidentimi i f mij ve n nevoj nga Zyra e Mbrojtjes s

		f mij ve" - Rregjistrimi l tyre n qend r - Kontratimi l m sueve t specializuar - Aktivitete sociale dhe ekskursione
12	<b>Organizata implementuese</b>	
13	<b>Zyra Përgjegjëse</b>	Zyra e Politikave të Zhvillimit dhe Projekteve Strategjike .
14	<b>Shënime</b>	

### Huamarrja vendore 2014

Gjatë vitit 2014 është planifikuar shlyerja e kredisë (disbursimi l parë, disbursimi l dytë dhe l tretë), e cila përbëhet nga pagesa e interesit dhe e principalit. Në bazë të planit të pagesave, pagesa e interesit dhe principalit për vitin 2014 është planifikuar në vlerën **28,622 mijë lekë** dhe konkretisht pagesa e interesit në vlerën **16,062 mijë lekë** dhe pagesa e principalit **12,560 mijë lekë**.

Për vitin 2014 fondi l planifikuar për principalin për disbursimin e parë është dhe **3,940 mijë lekë** dhe interesi **2,670 mijë lekë**.

Fondi l planifikuar për principalin për disbursimin e dytë është dhe **1,975 mijë lekë** dhe interesi **1,539 mijë lekë**.

Fondi l planifikuar për principalin për disbursimin e tretë është dhe **1,795 mijë lekë** dhe interesi **1,711 mijë lekë**.

Për vitin 2014 fondi l planifikuar për principalin për kredinë e përfituar nga CEB për ndërtimin e banesave me kosto të ulët është **4,850 mijë lekë**.

Fondi l planifikuar për interesin për kredinë e cila do të merret gjatë këtij viti është **10,142 mijë lekë**.

Pjesë përbërëse në Buxhetin e Bashkisë janë edhe pagesa e këshilltarëve, shërbimi urban, shërbimi funeral, pastrimi i qytetit, kontributi i Bashkisë për Qarkun, fondi i emergjencave civile, fondi rezervë dhe fondi i kontigjences si më poshtë:

### Këshilltarët

Pagesa e këshilltarëve është llogaritur në bazë të shpërblimit mujor prej 11.500 lekë (10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë), për çdo këshilltar. Edhe në Buxhetin e vitit 2014 fondi për pagesën e këshilltarëve është në vlerën **4,830 mijë lekë** e njëjtë me fondin e planifikuar në vitin 2013.

- Shërbimi i pastrimit të qytetit** Vlera e këtij shërbimi që kryhet nga firma "Korsel", fituese e tenderit është 58.902.056 lekë. Ky shërbim është një nga shërbimet më të rëndësishme që kryen Bashkia në shërbim të komunitetit. Objekti l këtij shërbimi është pastrimi i rrugëve dhe trotuareve, evadimi i mbetjeve urbane në qytetin e Korcës dhe përpunimi i tyre, lagja e rrugëve, evadimi i dëborës në stinën e dimrit dhe hedhja e kripës për lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe njerëzve, etj. Pastrimi l rrugëve bëhet cdo ditë prej orës 24.00 deri 06.00. Pastrohen cdo ditë 429.861 m<sup>2</sup> rrugë dhe trotuare. Transporti l mbeturinave për në fushën e grumbullimit dhe përpunimit të tyre bëhet cdo ditë me mjete teknologjike prej orës 03.00 deri 07.00 për evadimin e mbetjeve nëpër konteniere dhe prej orës 07.00 deri 11.00 nëpër lagjet që nuk kanë konteniere. Cdo ditë evadohen rreth 80 ton mbeturina. Lagja e rrugëve bëhet për periudhën 01.04 deri 31.10 cdo ditë nga ora 06.00 deri 18.00 në një sipërfaqe prej 295.870 m<sup>2</sup> si dhe larje speciale e rrugëve me sip. 70.236 m<sup>2</sup> cdo ditë.

Grumbullimi i mbeturinave bëhet me rreth 400 konteniere.

Gjatë vitit 2014 do të shlyhet edhe vlera prej 46,864 mijë lekësh detyrim nga viti 2013.

Fondi i planifikuar për paga për supervizorin e pastrimit për vitin 2014 do të jetë në vlerën **521 mijë lekësh**, dhe fondi i planifikuar për sigurime shoqërore për supervizorin e pastrimit do të jetë në vlerën **85 mijë lekë**.

2. **Shërbimi i transportit qytetës** kryhet nga shoqëria "Ortakëria Korca" dhe I jepet kësaj shoqërie në formë subvencioni duke u bazuar në kontratën e lidhur me këtë shoqëri. Në buxhetin e vitit 2014 ky shërbim do të planifikohet në vlerën 6,500 mijë lekë. Ky shërbim mbështetet në realizimin e zërave të mëposhtëm:

- a. Itenerari i përcaktuar në kontratë i mjeteve
- b. Orari i shërbimit të këtij transporti
- c. Numri i mjeteve në linjë
- d. Fluksi i kalimit të autobusëve nëpër stacionet e përcaktuara
- e. Qëndrimi i mjeteve nëpër stacionet e përcaktuara

Subjekti "Ortakëria" zbaton dhe nenin 3 të kontratës mbi udhëtimin falas të moshës së tretë dhe me gjysëm cmimi të biletës për studentët.

Për arsye të rritjes së numrit të pensionistëve të cilët janë pajisur me kartë udhëtimi falas mendojmë që vlera e subvencionit krahasuar me vitin 2013 të rritet me 1,000 mijë lekë më shumë.

3. **Shërbimi funeral dhe mirëmbajtja e varrezave publike dhe ato të dëshmorëve** . Vlera e këtij shërbimi fituar nga firma " Korsel" është 4,156,304 lekë. Ky shërbim konsiston në zërat e mëposhtëm :

- a. Pastrim parcelash , rrugë dhe sheshe të brendshme ndërmjet blloqeve të varrimit
- b. Mirëmbajtje drure dhe shkurre dekorative
- c. Mbjellje drure dekorative
- d. Mirëmbajtje dhe krijim gardhe të gjelbërt me ligustër dhe lavandine
- e. Kositje , grumbullim dhe transport bari
- f. Mirëmbajtje bordure betoni të brendshme
- g. Lyerje me gëlqere të bordurave dhe pemëve në varrezat publike dhe të dëshmorëve
- h. Ruajtja e objektit në varrezat publike dhe të dëshmorëve
- i. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve
- j. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve nga amortizimi
- k. Mirëmbajtje e murit rrethues
- l. Konsumi I ujit të pijshem për mirëmbajtje dhe nevojat e qytetarëve

Gjatë vitit 2014 do të shlyhet edhe vlera prej 275 mijë lekësh detyrim nga viti 2013.

### Kontributi për Qarkun

Në zbatim të ligjit nr.8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", ligjit nr. 185/2013 datë 2.12.2013 "Për buxhetin e vitit 2014, të udhëzimit nr. 2 datë 6.2.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" si dhe shkresës me nr. 1378 Prot. Datë 31.12.2012 nga institucioni i Prefektit, kuota për kontributin e qarkut do të jetë 3.4% e realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2014. Planifikimi për këtë vit do të jetë në vlerën **14,000 mijë lekë**, nga të cilat 4,000 mijë lekë janë detyrim nga viti 2013.

### Emergjencat civile

Fondi i emergjencave civile, në zbatim të ligjit 8756 dt. 26.03.2002 "Për emergjencat civile" neni 16, pika 2, gërma ç), është planifikuar si zë i vecantë në vlerën **500 mijë lekë**. Ky fond është planifikuar për t'i ardhur në ndihmë popullatës në raste emergjence nga fatkeqësi natyrore, ose fatkeqësi të tjera.

### Fondi rezervë

Fondi rezervë krijohet duke u bazuar në nenin 19/7.a.iii të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2009, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe neni 6 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", për të përballuar shpenzimet e paparashikuara në buxhetin e njëjtit të qeverisjes vendore. Fondi rezervë për vitin 2014 do të jetë në vlerën **1,000 mijë lekë**. Ky fond duhet të jetë jo më shumë se 3% të totalit të shpenzimeve të miratuara.

### TRANSFERTAT 2014

Fondi për transfertat tek institucione apo organizata të ndryshme për vitin 2014 do të jetë në vlerën **10,300 mijë lekë** të detajuara si më poshtë:

- Kontributi i Bashkisë për KRWM sh.a. për vitin 2014 do të jetë 3,000 mijë lekë.
- Vlera e projekteve të cilat do të menaxhohen nga Bashkia për vitin 2014 do të jetë 1,800 mijë lekësh ku:
  - 1,000 mijë lekë do të jetë kontributi për Qendër Komunitare për të Moshuarit
  - 400 mijë lekë do të jetë kontributi për fëmijët në nevojë
  - 400 mijë lekë do të jetë kontributi për projektin mbështetje për personat e moshuar dhe vetmuar
- Kontributi i Bashkisë për UKKO në vlerën 4,000 mijë lekë.
- 1,500 mijë lekë kontributi i Bashkisë për ndërtimin e qendrës komunitare për integrim social ku përfshihet dhe rikonstruksioni i Këndit të lojtrave me dorë.

-transferta tek individët **100 mijë lekë**

- Transferta tek individët (ndihmë për qytetarët në vështirësi ekonomike) do të jetë 100 mijë lekë. Përdorimi i këtij fondi do të bëhet me urdhër të Kryetarit.

## SHPENZIME PER INVESTIME PER VITIN 2014

Investimet e Bashkisë për vitin 2014 janë planifikuar në vlerën 99,163 mijë lekë dhe do të realizohen nga të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore.

Detajimi sipas programeve do të jetë:

1.	Programi i infrastrukturës rrugore për vitin 2014	57,185 mijë lekë
2.	Programi i administrimit të përgjithshëm (blerje pajisje dhe rikonstruksione në ambientet e Bashkisë)	4,343 mijë lekë
3.	Programi i shërbimeve publike	21,759 mijë lekë
4.	Programi studime urbanistike	6,590 mijë lekë
5.	Programi i Investimeve (kulturë e sport )	9,286 mijë lekë

### Programi i infrastrukturës rrugore

Vlera e planifikuar për investime në infrastrukturën rrugore për vitin 2014 është **57,185 mijë lekë**, të cilat janë detyrime të vitit 2013 të cilat do të likuidohen gjatë vitit 2014.

### Programi i administrimit të përgjithshëm

Vlera e planifikuar për investime në këtë program është **4,343 mijë lekë** nga të cilat:

4,000 mijë lekë planifikuar në vitin 2014 dhe

343 mijë lekë janë detyrime të vitit 2013 të cilat do të likuidohen gjatë vitit 2014.

### Programi i shërbimeve publike

Vlera e planifikuar për investime në këtë program është **21,759 mijë lekë** nga të cilat:

7,891 mijë lekë planifikuar për vitin 2014 dhe

13,868 mijë lekë janë detyrime të vitit 2013 të cilat do të likuidohen gjatë vitit 2014.

### Studime urbanistike

Vlera prej **6,590 mijë lekësh** nga të cilat:

3,600 mijë lekë planifikuar për vitin 2014 dhe

2,990 mijë lekë janë detyrime të vitit 2013 të cilat do të likuidohen gjatë vitit 2014.

### Investime në kulturë

Vlera e planifikuar prej **9,286 mijë lek**, të cilat janë detyrime të vitit 2013 të cilat do të likuidohen gjatë vitit 2014.

Në zbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" si dhe udhëzimit nr. 2 datë 6.2.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", detajimi i secilit program të investimeve në nivel projekti do të kryhet nga Kryetari i Njësisë Vendore dhe do të paraqiten për informacion në Këshillin Bashkiak.

**BUXHETI I INSTITUCIONEVE TE VARTESISE SIPAS PROGRAMEVE PER VITIN 2014****✓ Programi i arsimit**

Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse e Arsimit dhe Cerdhes do të funksionojë me një staf prej 55 punonjës të detajuar si më poshtë:

Cerdhja 12 punonjës

Arsimi 9 vjeçar 18 punonjës

Arsimi profesional 25 punonjës

Buxheti i planifikuar për vitin 2014 në total për këtë institucion shkon në vlerën **107,791 mijë lekë** nga të cilat:

90,420 mijë lekë në buxhetin e vitit 2014 dhe

17,371 mijë lekë detyrime nga viti 2013

Ky institucion funksionon për të përmbushur të gjitha detyrimet, për mbarëvajtjen e të tre sektorëve të arsimit, dhe krijimin e kushteve për mirëfunksionimin e 41 institucioneve arsimore me qëllim sigurimin e të gjithë bazës materiale të nevojshme për riparimin e difekteve, meremetimeve si dhe për të siguruar furnizimin e domosdoshëm me lëndë djegëse si për ngrohje dhe për gatim, si dhe për të bërë të mundur shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve si fatura uji, energjie elektrike, telefoni etj, sigurimin e ngrohjes dhe ushqimin e konvikteve dhe kopshteve. Buxheti jepet i detajuar si më poshtë :

**Buxheti i Cerdhes**

-Shpenzime për personelin 5,010 mijë lekë

-Shpenzime korrente 1,843 mijë lekë

-Shpenzime për investime (blerje paisje) 50 mijë lekë

**Total 6,903 mijë lekë**

Fondi i planifikuar i shpenzimeve për paga për vitin 2014 do të jetë **4.310 mijë lekë** dhe krahasuar me fondin e planifikuar të vitit 2013 ka një rritje prej 280 ose 6.9% më shumë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore për vitin 2014 do të jetë **700 mijë lekë** dhe krahasuar me fondin e planifikuar të vitit 2013 ka një rritje prej 49 ose 7% më shumë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative do të jetë **1,843 mijë lekë** nga të cilat 293 mijë lekë janë detyrime dhe krahasuar me fondin e planifikuar të vitit 2013 ka një ulje prej 122 ose 6% më pak nga të cilat:

1,550 mijë lekë planifikuar për vitin 2014 dhe

293 mijë lekë detyrim nga viti 2013

Tabela e shpenzimeve operative paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Cerdhe	F 2012	Det	fakt	PI 2013	PI nd	fakt 12m	det	fakt +det	PI 2014	PI14- P13	%	PI14- F+det	%
1	Uje	50			50	50	50		50	50	0	100%	0	100%
2	Energji	120			120	120	120		120	120	0	100%	0	100%
3	Telefon	30			30	30	30		30	30	0	100%	0	100%
4	Blerje te ndryshme	90			70	70	70		70	100	30	143%	30	143%
5	Mirembajtje	100			100	100	100		100	50	-50	50%	-50	50%
6	Ushqime	849	395	395	1,200	1,200	907	293	1,200	1,200	0	100%	0	100%
	<b>Total shp operative</b>	<b>1,239</b>	<b>395</b>	<b>395</b>	<b>1,570</b>	<b>1,570</b>	<b>1,277</b>	<b>293</b>	<b>1,570</b>	<b>1,550</b>	<b>-20</b>	<b>99%</b>	<b>-20</b>	<b>99%</b>

### Buxheti Arsimi 9 vj

-Shpenzime për personelin 9,270 mijë lekë

-Shpenzime korrente 43,374 mijë lekë

-Shpenzime për investime (blerje paisje) 2,396 mijë lekë

**Total 55,040 mijë lekë**

- Fondi i planifikuar për paga për vitin 2014 për arsimin 9 vj do të jetë **7,970 mijë lekë** ose 50 mijë lekë më pak se viti 2013.
- Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore do të jetë **1,300 mijë lekë** ose 4 mijë lekë më pak se viti 2013.
- Fondi i planifikuar për shpenzime operative do të jetë **42,220 mijë lekë** ku:

36,219 mijë lekë janë planifikuar për vitin 2014 dhe

6001 mijë lekë detyrim nga viti 2013

- Fondi i planifikuar për transferta tek individët, projekti bursa për gjimnazistët do të jetë **1,155 mijë lekë** ku:

945 mijë lekë janë planifikuar për vitin 2014 dhe

210 mijë lekë detyrim nga viti 2013

- Fondi i planifikuar për investime do të jetë **2,396 mijë lekë** ku:

2,148 mijë lekë janë planifikuar për vitin 2014 dhe

248 mijë lekë detyrim nga viti 2013

### Buxheti Arsimi i mesëm

-Shpenzime korrente 15,635 mijë lekë

-Shpenzime për investime (blerje paisje) 2,263 mijë lekë

**Total 17,898 mijë lekë**

Fondi i planifikuar për shpenzime operative është:

11,000 mijë lekë planifikuar për vitin 2014 dhe

4,635 mijë lekë detyrim nga viti 2013

Fondi i planifikuar për investime do të jetë 2,263 mijë lekë nga të cilat 229 mijë lekë janë detyrime nga viti 2013.

**Buxheti Arsimit profesional**

-Shpenzime për personelin 10,893 mijë lekë

-Shpenzime korrente 17,055 mijë lekë

**Total 27,948 mijë lekë**

- Fondi I planifikuar për paga për vitin 2014 për arsimin profesional do të jetë **9,370 mijë lekë** dhe krahasuar me planin e vitit 2013 ka një ulje prej 560 mijë lekësh ose 6% më pak.
- Fondi I planifikuar për sigurime shoqërore për vitin 2014 për arsimin profesional do të jetë **1,523 mijë lekë** dhe krahasuar me planin e vitit 2013 ka një ulje prej 80 mijë lekësh ose 5% më pak.
- Fondi i planifikuar për shpenzime operative do të jetë **17,055 mijë lekë** ku

11,300 mijë lekë planifikuar për vitin 2014 dhe 5,755 mijë lekë detyrim nga viti 2013

Detajimi i shpenzimeve operative të planifikuara për vitin 2014 për arsimin 9 vj, arsimin e mesëm dhe arsimin profesional jepet si më poshtë:

000/lekë

Nr.	NSHMAC	F 2012	Det 2012	Fakt	PI 2013	PI nd	fakt 12m	det	fakt +det	PI 2014	PI14-P13	%	PI14-F+det	%
1	Uje	5,289			5,000	5,000	4,411		4,411	5,000	0	100%	589	113%
2	Energji	5,006			5,000	6,885	5,661		5,661	6,500	-385	94%	839	115%
3	Telefon	1,384			1,500	1,900	1,622	138	1,760	1,800	-100	95%	40	102%
4	Dru zjarri	1,110	1,259	1,259	2,600	2,600	392	2,196	2,588	2,400	-200	92%	-188	93%
5	Nafte	10,312	5,522	5,522	12,000	12,000	5,329	6,172	11,501	12,000	0	100%	499	104%
6	Vendim gjyqesore								0		0	#DIV/0!	0	
7	Shpenzime per Q.K.F.	852	270	270	800	800	530	234	764	800	0	100%	36	105%
8	Gaz I lengshem	1,216	306	306	800	800	467	333	800	800	0	100%	0	100%
9	Dieta	20	8	8	40	40	20		20	40	0	100%	20	200%
10	Meremete	4,990	264	264	7,700	5,710	3,751	1,949	5,700	8,000	2,290	140%	2,300	140%
11	Mbikqyrje meremete					130	44		44	170	40	131%	126	386%
12	Koaludime meremete					20			0	35	15	175%	35	####
13	Punime me dru	729	114	114	900	829	626		626	800	-29	97%	174	128%
14	Mbikqyrje punime me dru					20			0	20	0	100%	20	####
15	Koaludime punime me dru					6	6		6	6	0	100%	0	100%
16	Blerje te ndryshme	3,495	1,301	1,301	5,413	5,213	4,187	426	4,613	5,000	-213	96%	387	108%
17	Blerje te ndryshme xhama				0	200			0		-200	0%	0	
18	Ushqime	6,569	5,366	5,366	10,400	10,000	5,447	4,553	10,000	12,400	2,400	124%	2,400	124%
19	Shpenzime per roje	1,467	134	134	1,620	1,620	1,350	270	1,620	1,800	180	111%	180	111%
20	Ambiente me qera	462	18	18	360	360	240	120	360	360	0	100%	0	100%
21	Libra dhe Publikime				100	100	100		100	125	25	125%	25	125%
22	Kancelari				50	50	50		50	56	6	112%	6	112%
23	Sherb te print dhe publikimit	470			35	35	35		35	106	71	303%	71	303%
24	Shpenzime transporti				132	132	132		132	132	0	100%	0	100%
25	tonia				5	5	5		5	10	5	200%	5	200%
26	Shp pritje percjellje				140	140	140		140	105	-35	75%	-35	75%
27	Shp per materiale dhe sherbime				48	48	48		48	54	6	113%	6	113%
	<b>Total</b>	<b>43,371</b>	<b>14,562</b>	<b>14,562</b>	<b>54,643</b>	<b>54,643</b>	<b>34,593</b>	<b>16,391</b>	<b>50,984</b>	<b>58,519</b>	<b>3,876</b>	<b>107%</b>	<b>7,535</b>	<b>115%</b>
	<b>Total shp operative</b>	<b>43,371</b>	<b>14,562</b>	<b>14,562</b>	<b>54,643</b>	<b>54,643</b>	<b>34,593</b>	<b>16,391</b>	<b>50,984</b>	<b>58,519</b>	<b>3,876</b>	<b>107%</b>	<b>7,535</b>	<b>115%</b>

Siç shihet nga tabela e mësipërme buxheti i planifikuar për shpenzime operative për arsimin 9 vjeçar, arsimin e mesëm dhe arsimin profesional krahasuar me vitin 2013 ka një rritje prej 3,876 mijë lekësh ose 7% më shumë dhe nëse e krahasojmë me faktin e vitit 2013 dhe detyrimet e vitit 2013 ka një rritje prej 7,578 mijë lekë ose një rritje prej 15%.

Gjatë vitit 2014 kjo njësi shpenzuese do të realizojë projekte në vlerën **1,533 mijë lekë** nga të cilat 588 mijë lekë janë shpenzime operative dhe 945 mijë lekë janë transferta, të detajuara si më poshtë:

Emertimi i Projektit	Libra dhe publikime prof	Te tj mat dhe sherb speciale	Kancelari	Sherbime te print & pub	Sherbime te tjera	Shp te tjera transporti	Blerje sherb fonia	Shp per pritje percjellje	Shp te tj mat dhe Sh	Bursa	TOTALI
	6021007	6E+06	6020100	6E+06	6E+06	6023900	6E+06	6E+06	6E+06	6061021	
Bursa per gjimnazistet				20,000				35,000		945,000	1,000,000
Kite shkollore per femijet jetime	100,000										100,000
Dita e te drejtave te femijeve				71,500							71,500
Kampe verore			50,000			132,000			18,000		200,000
Festa e 1 Qershorit	25,000	10,000	6,200				10,000		10,000		61,200
Respekt per mesuesin					40,000			60,000			100,000
<b>TOTALI</b>	<b>125,000</b>	<b>10,000</b>	<b>56,200</b>	<b>91,500</b>	<b>40,000</b>	<b>132,000</b>	<b>10,000</b>	<b>95,000</b>	<b>28,000</b>	<b>945,000</b>	<b>1,532,700</b>

✓ "Bursa per gjimnazistet"

Nr.		
1	<b>Programi</b>	Qyteti mbeshtet t rinjt
2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Bursa p r gjimnazist t</b>
3	<b>Kohëzgjatja</b>	Gjat vitit
4	<b>Data e fillimit</b>	2014
5	<b>Donatorë potencialë</b>	
6	<b>Kostoja totale</b>	
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	1 000 000
8	<b>Fond shtesë</b>	
9	<b>Rezultatet</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Nxenesit me te pergatitur te shkollave jane perfituese direkte te projektit, pasi ata perfitojne anen materiale dhe morale. Keta nxenes vleresohen materialisht per rezultatet e tyre te larta dhe stimulohen qe te vazhdojne te mesojne duke hedhur cdo dite e me shume hapa te reja te se ardhmes se tyre.</li> <li>2. Brezat e tjere, duke u nxitur per te dhene perpjekjet e tyre maksimale ne pergatitjen mesimore, si perfitues indirekte, marrin shembullin e ketyre nxenesve.</li> <li>3. Bashkia e Korces, nepermjet dhenies te stimulit material, rrit imazhin e saj ne forcimin e lidhjeve me te rinjte dhe u krijojn atyre kushte vleresuese per t'ju dhene nje motiv me shume te progresit te tyre.</li> <li>4. Prinderit duke qene perfituesit indirekte te projektit, vleresohen per perpjekjet dhe perkushtimet ndaj femijet e tyre.</li> </ol>
10	<b>Objektivat</b>	<p>Qellimi: Stimulimi dhe nxitja e nxenesve per arritjen e rezultateve sa me te larta.</p> <p>Objektivi I: Vleresimi i nxenesve per rezultatet e larta ne mesime, duke cuar ne progres te metejshe per vitet akademike ne vazhdim.</p>

		Objektivi 2: Nxitja e brezave të tjera që do të vijne, për arritjen e rezultateve të mira. Objektivi 3: Stimulimi i nxenesve në formën e një vlerësimi material, i cili do t'u jetë i vlefshëm në të ardhmen
11	<b>Aktivitetet kryesore</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përcaktimi i nxenesve me rezultate më të larta me ndihmën e Drejtorisë Arsimore.</li> <li>2. Përzgjedhja e nxenesve me të mirë.</li> <li>3. Zhvillimi i ceremonisë për dhenien e stimulit.</li> </ol>
12	<b>Institucioni</b>	NSHMAC
13	<b>Zyra Përgjegjëse</b>	Zyra e Politikave të Zhvillimit dhe Projekteve Strategjike .
14	<b>Shënime</b>	

✓ "Kite shkollore për fëmijet në nevojë"

Nr.		
1	<b>Programi</b>	Qyteti Social
2	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Kite shkollore për fëmijet në nevojë</b>
3	<b>Kohëzgjatja</b>	2 muaj
4	<b>Data e fillimit</b>	Shtator 2014
5	<b>Donatorë potencialë</b>	
6	<b>Kostoja totale</b>	
7	<b>Fondi i bashkisë</b>	100 000 Lek
8	<b>Fond shtesë</b>	
9	<b>Rezultatet</b>	<p>Realizimi i këtij projekti do të shërbejë në:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>A) Dhënie e ndihmesës për fëmijët jetimë, nëpërmjet pajisjes së tyre me mjete të nevojshme shkollore me qëllim përmirësimin e kushteve të tyre mësimore si një drejtë e tyre për tu ndjerë të barabartë me bashkëmoshatarët e tyre.</li> <li>B) Zbutjen e varfërisë të këtyre familjeve në nevojë.</li> <li>C) Marrjen e një vlerësimi moral dhe material i familjarëve apo të afërmeve të fëmijëve nga pushteti lokal.</li> <li>D) Angazhimin e fëmijëve jetimë në studimet shkollore për të arritur rezultate sa më të larta.</li> <li>E) Largimin e fëmijëve jetimë nga rruga dhe puna e zezë për t'ju rikthyer shkollës. Kjo do të ndikojë gjithashtu edhe në uljen e numrit të braktisjes së shkollës nga fëmijët jetimë.</li> </ol>
10	<b>Objektivat</b>	<p><b>Qëllimi:</b> Dhënie e mjeteve shkollore për fëmijët jetimë, si një ndihmesë për ndjekjen e shkollës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisja e nxënësve jetimë me libra shkollore para fillimit të vitit shkollor.</li> <li>• Përmirësimi i jetës shkollore dhe krijimi i kushteve mësimore për fëmijet jetimë në masën 100%.</li> </ul>
11	<b>Aktivitetet kryesore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikimi i fëmijëve jetimë në bashkëpunim me Zyrën e Mbrotjtjes së të Drejtave të Fëmijëve dhe Shoqatën e Fëmijëve Jetimë.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i një database me të gjitha të dhënat e nevojshme.</li> <li>• Përcaktimi i librave shkollore që nevojiten.</li> <li>• Blerja e librave shkollore dhe paketimi i tyre.</li> <li>• Njoftimi i familjeve të fëmijëve jetimë për datën e shpërndarjes së librave dhe organizimi i këtij aktiviteti.</li> <li>• Zhvillimi i aktivitetit me pjesëmarrjen e fëmijëve, familjeve të tyre, bashkisë dhe të ftuarve të tjerë</li> </ul>
12	Institucioni	NSHMAC
13	Zyra Përgjegjëse	Zyra e Politikave të Zhvillimit dhe Projekteve Strategjike .
14	Shënime	

✓ **Dita e të drejtave të fëmijëve**

Nr.		
1	Programi	Qyteti Social
